

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal, gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh.Sh nga fsh... KK ..., për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshem te prones se paluajtshme nga neni 332 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.3450/2015 të datës 05.01.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit, me datë **27.07.2016**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **Xh.Sh**, nga i ati F., e ëma N., e vajzërisë ..., i lindur më datë ... në fsh... KK ..., ku edhe tani jeton, i martuar baba i 4 femijeve, ka të kryer shkollen fillore 4 vite, pensionist, i gjendjes se dobet ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves,

ËSHTË FAJTOR

Se gjate vitit 2015, ne menyre te kunderligjshme kishte uzurpuar pronen publike te autoritetit komunal te pyjeve te KK ne Prizren, zones katastrale "...", ngastren me nr...., dhe ate siperfaqen prej 0,60 ari, ne vendin e quajtur "...” ngastra 151, kishte ndertuar shtepi familjare me kete autoritetit te permendur i shkakton dëm,

-kësodore kryen veprën penale uzurpim i paligjshem te prones se paluajtshme nga neni 332 par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 43, par.1 pika 1.3, 46, 49 par.1 p.1.1,73, 74, 75 e 76 te KPK-se , si dhe nenit 365 te KP-se, te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBE

Ne lartesi prej **200 /dyqinde/ Euro** te cilen shume te denimit i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi. Gjykata e obligon te akuzuarin qe denimin me gjobe ta paguaj me 4 kiste, dhe ate duke filluar secili kist ne fillim te muajit vijues nga dt.01. e deri me dt.05. te fillimit te muajit, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejt do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, rrespektivisht 10 dite burgim.

I akuzuari obligohet qe te paguaj shpenzimet e procedures penale sado qe te jene ato, ne emer te shpenzimeve te paushalit gjyqesor shumen prej **30,00 euro**, ne afatin prej 15 diteve, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi.

Perfaqesuesi i te demtuares – autoriteti komunal pyjor KK Prizren, per realizimin e kerkeses pasuroro juridike, udhezohet ne kontest te rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me PP. nr.3450/2015 te dt.05.01.2016, kunder te akuzuarit Xh.Sh nga fsh.... KK ..., per shkak te vepres penale uzurpim i paligjshem te prones se paluajtshme nga neni 332 par.1 te KP-es.

Prokurori i shtetit ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi: ne teresi qendron prane aktakuzes se lartecekur, kunder te akuzuarit Xh.Sh per shkak te vepres penale te lartecekur, edhe pse i akuzuari ne menyre vullnetare e ka pranuar fajesin, duke i pasur parasysh edhe provat e tjera qe i bashkangjiten shkresave te lendes propozoj qe i njehti te shpallet fajtor dhe te denohet sipas ligjit.

I akuzuari ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi: e pranon fajesin ne menyre vullnetare per vepren penale e cila i ngarkohet, per kete veper penale eshte i penduar, betohet se ne te ardhmen do te jete me i kujdesshem dhe nuk do te perseris keso lloj te vepres penale, objekti i banimit nuk eshte ne emrin e tije por ate objekt e shfrytezojne djemt e tije, per momentin eshte pensionist, me gjendje te dobet ekonomike, jeton ne bashkesi familjare 17 anetareshe.

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesise per vepren penale e cila i vihete ne bare, e qe pranimi i fajesise eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuzen, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykat ka ardhur ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale uzurpim i paligjshem i prones se paluajtshme nga neni 332 par.1 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, me pare i pagjykuar, çka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive ne kuptim te dispozitave te nenit 74, 75, e 76 gjykata morri per baze edhe faktin qe i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin dhe ka shprehur keqardhje per vepren e kryer penale dhe poashtu edhe ka pasur sjellje korrekte para gjykates, pensionist, i gjendjes se dobet ekonomike, andaj gjykata i shqiptoi denimin me gjobe, sepse konsideron se me me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i

shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 453 te KPPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr. 3/2016 të datës 27.07.2016

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqur ka te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.